

FALGRO TABLET

FALGRO TABLET përmban acid giberelik GA₃, një rregullator natyral i rritjes së bimëve i marrë me rruge fermentative e cila gjendet natyrshëm në shumë lloje bimesh. Acidi giberelik ndikon në shumë procese biologjike, duke përfshirë rritjen dhe zhvillimin e bimëve, lulëzimin, lidhjen frutave, futjen me heret ne prodhim. Koha e duhur e aplikimit është vendimtare për suksesin e trajtimit.

Përmbajtja: 100 g produkt përmban: Acid giberelik (A₃) i pastër 18,37 g; Ko-formulantë q.b deri në 100 g (një tabletë 4,9 gram përmban 1 g lende aktive (l.a.) e barabartë me 0,9 g lende aktiv të pastër).

Formulimi: Ne forme tabletash.

Këshilla per kujdesin:

P102: Mbajeni larg aritjes prej fëmijëve.

P270: Mos hani, pini ose pini duhan gjate përdorimit.

EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim.

Asgjesoni amblazhet sipas rregulloreve në fuqi.

Mbrojtja e operatorëve:

Vishni mjete të përshtatshme mbrojtëse si kominoshe dhe doreza kur përdorniproduktin. Nese ndoteni ne lekure ose ne sy shplahuni menjehere me kujdes. Lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit para ngrënies dhe pas punës. Lani tërësisht të gjitha veshjet mbrojtëse paspërdorimit. FALGRO® TABLET nuk eshte helmues por ne rast perzierjesh me produkte te tjera nuk ndiheni mire informoni mjekun e nje qender shendetesore mbi perzierjen e kryer.

Përdorimi:

Agrume: përdoret për të permiesuar lidhjen e frutave në agrume. Perdoret 1 tablet/hl (klementinë, mandarinë) dhe 1-2 tableta/hl (portokall, limon).

Tek klementina dhe mandarinat trajtimi i pare kyhet ndërmjet lulëzimit të plotë dhe rënies së 2/3 të petaleve, përsëritet nëse është e nevojshme, veçanërisht nëse periudha e lulëzimit zgjatet.

Mund të përdoret për të vonuar maturimin. Në portokall, kryeni një trajtim të vetëm me 1-2 tableta/hl para fillimit të ngjyrosjes, për të vonuar pjekjen dhe për të marrë një lëkurë më cilësore në kohën e vjeljes. Tek limonat bëni një trajtim të vetëm me 1-2 tableta/hl para fillimit te ngjyrosjes, për të vonuar pjekjen, reduktuar numrin e frutave të vegjël dhe rritur madhësinë dhe peshën e frutave. pH ideal për tretësirën që do të spërkatet mbi agrumet është 4-5.5, për të arritur thithjen maksimale të GA₃.

Paralajmërim: Administrimi i acidit giberelik në disa kultivarë agrumesh, si Turkey Valencia dhe Bauhinia Navelina, mund të jetë fitotoksik në kushte të caktuara të pafavorshme të rritjes.

Doza maksimale 20 gr/l.a./ha. Numri maksimal i trajtimeve në sezon: 2 në klementinë dhe mandarinë, 1 në portokall dhe limon

Dardhe: Përdoret per të përmirësuar lidhjen e frutave në varietetet me me lidhje te dobet, kryhet nje trajtim gjatë lulëzimit (midis 20-30% lulezim dhe fund lulëzimi). Perdorimi deri në 1,2 tableta/hl për aplikim të drejtpërdrejtë, 0,3 tableta/hl nëse përzihet me PERLAN. Doza maksimale 12 gr/l.a. ha.

Numri maksimal i trajtimeve për sezon: 1. Gjithashtu mund të administrohet menjëherë pas ngricës (brenda 48 orëve), gjatë lulëzimit ose lidhjes së frutave për të reduktuar dëmtimet nga ngrica.

Paralajmërim: Menaxhimi agroteknik i pemtoreve (veçanërisht krasitja dhe mirembajtja vegjetative) dhe sistemi i plehërimit duhet të aplikohen sipas ngarkesës së synuar të frutave. Një dozë shumë e lartë mund të ndryshojë pamjen e frutave (zgjatja e frutit) dhe pakësim te lulëzimit në vitin pasardhës vecanerisht ne pemtore jo te shendetshme.

Vresht: Në varietetet e rrushit të tavolines pa fara: (Sulltanine, Thomson), per rritjen e gjatësisë se frenjve (shkiferimin e veshulit) trajtojmë para lulëzimit kur lastari eshte 4-8 cm. Ndersa per rallimin e veshulit trajtimi kyhet ne fazen e 30-40% të lulëzimit. Perdoret 0,5-1 tablet/hl.

Ne varietetet e tjera te tavolines: Per te mare kokrra me te medha dhe uniforme aplikoni me dozën 3 tableta/hl, ne periudhen e lidhjes se frutave deri kur kokrrat të arrijnë një diameter prej 3-4 mm dhe përsëritni trajtimin pas 5-12 ditëve. Per të favorizua lidhjen e frutave dhe hershmërinë e podhimit perdoren 3 tableta/hl, duke kyer nje trajtim ne lulëzim të plotë, i përsëritur pas 5-12 ditëve.

Në rrushin e verës (Chardonnay, Picolit, Tocai, etj.), për të përmirësuar gjatësinë e frejve dhe për të zvogëluar

kompaktësinë e veshulit dhe ulur potencialin e infeksioni nga Botrytis cinerea, perdoret 0,5-1 tablet/hl para lulëzimit, kur lastaret jane 10-15 cm.

Në rrushin sulltanin, per te nxitur rritjen e madhesise se kokrrave, kryhet një trajtim me 0,5-1 tablet/hl, kur kokrra ka arritur një diametër prej 3 mm.

Në varietetin Corinto nero, per te reduktuar rënien e luleve dhe frutave kryhet një trajtim i vetëm me 0,5 tableta/hl, në lulëzim të plotë. Përdorimi i përzier në me një adjuvant (SILWET GOLD) mund të përmirësojë depërtimin dhe efektivitetin e produktit.

Kujdes: Zvogëloni dozën në varietete shumë të ndjeshme si Riesling. Doza maksimale 60 gr/l.a./ha. Numri maksimal i trajtimeve në sezon: 2 për rrushin e tavolines, 1 për rrushin e verës dhe Sulltaninen.

Qersh: Për të marrë qersh më të forta dhe më cilësore, aplikimi behet rreth 3 javë përpara datës së parashikuar të vjeljes, kur qershitë marrin ngjyrë të verdhë kashte, duke perdour 1-2 tableta/hl. Vonon pjekjen e frutave me 4 ose 5 ditë, duke zgjatur periudhën e vjeljes dhe rrit ndjeshmërinë ndaj plasaritjeve prej shirave. Trajtim rrit edhe madhësinë e frutit, duke e bërë atë më të fortë dhe më rezistent ndaj problemeve pas vjeljes. Numri maksimal i trajtimeve për sezon: 1. Doza maksimale 20 gr/l.a./ha.

Angjinare: Për të marrë prodhim të hershëm dhe për të përmirësuar cilësinë dhe rendimentin, perdoret 1-2 tableta/hl. Trajtimi i parë duhet të kryhet gjatë formimit të lules qendrore (duke filluar nga 1-2 gjethe reale) dhe mund të përsëritet pas 15-20 ditësh.

Kujdes: Për të patur efektivitet është e nevojshme të kemi edhe një regjim të mirë pleherimi. Doza maksimale 60 gr/l.a./ha. Numri maksimal i trajtimeve për sezon: 3.

Domate në serë: Për të garantuar një lidhje të mirë të frutave dhe hershmerine e podhimit, rekomandohet te perdoret ne fazat e para te lulëzimit, i lokalizuar ne pjesen e lulerise. Nëse është e nevojshme, trajtimi mund të përsëritet në katin tjetër të lulërise. Perdoren 1-2 tableta/hl, duke spërkatur direkt vetem mbi lulerite e reja. Doza maksimale 60 gr/l.a./ha. Numri maksimal i trajtimeve për sezon: 3.

Ornamentale (Spathiphyllum, Chrysanthemum, Cyclamen): Në varësi të kohës së aplikimit, trajtimi mund të stimulojë rritjen vegetative ose të nxisë lulëzim të hershëm dhe më të bollshëm. Prandaj, vendosja e saktë e trajtimit duhet të përcaktohet në bazë të kulturës dhe funksionit për të patur efektin e dëshiruar. Përdorimi: 2-16 tableta/hl. Numri maksimal i trajtimeve për sezon: 1.

Pregatitja e solucionit: Pas përcaktimit të dozës se nevojshme sipas kulturave, hidhni numrin e duhur të tabletave në rezervuar të mbushur me 1/2 e kapacitetit total, përziheni dhe shtoni sasinë e mbetur të ujit.

Verejtje për përdorimin:

Përdorni vëltime të larta uji për të siguruar mbulimin e plotë të bimeve. Aplikoni volume solucionit në varësi të fazave vegetative dhe masës bimë. Spërkatja preferohet të kryhet në mëngjes ose në mbrëmje kur është lagështia relative më e madhe. Rekomandohet të shtohet SILWT GOLD në mënyrë që të sigurohet përthithja sa më e lartë nga masa bimë. Mos aplikoni në bimë në kushte të stresit të ujit. Mos e lini tretësirën në rezervuar për periudha të gjata (psh. gjatë vakteve ose gjatë natës). Shpëlahjeni rezervuarin me ujë të pastër dhe spërkateni në zonën e trajtuar.

Përputhshmëria: Nuk duhet të përzihet me vajra minerale dhe përzierje alkaline si leng bodolezose kalcium sulfate. Mos kryeni trajtime pa kaluar dy javë nga përdorimi i vajrave minerale verore. Konsultohuni me specialistin mbi përdorimin në përzierje me agrokimikate të tjera.

Kujdes: Të përdoret ekskluzivisht sipas kushteve të treguara në këtë etiketë. Kushdo që përdor produktin është përgjegjës për çdo dëmtim që vjen nga përdorimi jo i duhur i preparatit. Pajtuëshmëria me udhëzimet e sipërpërmendura është një kusht thelbësor për efektivitetin e trajtimit dhe shmangien e dëmeve në bimë, njerëz dhe kafshë. Mos e shisni në ambalazhe të hapura. Mos kontaminoni kulturat e tjera, ushqimet, pijet ose rrugët ujore. Mos trajtoni në mot me erë. Ambalazhi nuk mund të përdoret për qëllime të tjera dhe nuk duhet të shpërndahet në mjedis.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Ndikimi në ekosistem:

EUH401: Të evitohen rreziqet e shëndetit të njeriut dhe ambientit, në përputhshmëri me instruksionet për përdorim. SP1: Mos e ndotni ujin me këtë produkt ose paketimin e tij. Mos i pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujërave. Shmangni kontaminimin përmes kanaleve komunale, të oborreve dhe rrugëve. Për të mbrojtur organizmat ujorë, respektoni një zonë tampon e patrajtuar prej 5 m nga bregu ujor sipërfaqësor.

Karenca:

Nuk aplikohet. Kujdes: në rast të përzierjes me formulime të tjera, aplikoni periudhen e karences me te gjate.

Ruajtja dhe magazinimi:

Ruajeni në vend të thatë të freskët, në ambalazhin origjinal, të mbyllur mirë, larg fëmijëve dhe kafshëve.

Numri dhe data e regjistrimit: 337, date 12.5.2023;

Dt.Prod/Batch.No.:Printuar nePaketim: ;

Emri dhe adresa e kërkuesit: Fine Agrochemicals LTD. **Adresa:** Hill End House, WhittingtonWorcester WR5 2RQ, Britani e Madhe;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Fine Agrochemicals LTD. **Adresa:** Hill End House, Whittington Worcester WR5 2RQ, Britani e Madhe.

SASIA :.....